

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-1595
Më 21.2.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 21.2.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e nënkryetarit të Komunës për ndryshimin dhe plotësimin e dy konkluzioneve nr. 01/06-1275, të datës 7.2.2012, që kanë të bëjnë me shitjen e autoveturave zyrtare, të cilat janë jashtë përdorimit, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

I. Miratohet propozimi i nënkryetarit të Komunës për ndryshimin dhe plotësimin e dy konkluzioneve nr. 01/06-1275, të datës 7.2.2012, që kanë të bëjnë me shitjen e autoveturave zyrtare, të cilat janë jashtë përdorimit dhe do të jetë kështu:

II. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, i datës 3.2.2012, dhe i Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, i datës 2.2.2012, rreth lejimit të shitjes së dy autoveturave zyrtare të Sektorit të Pylltarisë (Lada Niva dhe Toyota), dhe të dy autoveturave të QPS (Lada Niva) të cilat janë jashtë përdorimit, kështu që lejohen të zhvillohen procedurat e parapara ligjore për vlerësimin faktik dhe juridik të autoveturave të lartcekura, me qëllim që të zhvillohen procedurat e parapara ligjore për shitjen dhe likuidimin e tyre.

III. Për këtë qëllim formohet komisioni në këtë përbërje: 1. Hajrullah Hoxha, nga DBZHR, 2. Reshat Mehmeti nga DPMS dhe 3. Zekë Tejceci nga DSHP.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, komisioni dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit.

Me këtë konkluzion të njoftohen Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, komisioni, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit, nënkryetari i Komunës, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-1595
Më 21.2.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 21.2.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës rreth shqyrtimit dhe miratimit të raportit të prezantuar nga Komisioni për regjistrimin e inventarit dhe pajisjeve të tjera – pronë komunale në të gjitha objektet e Komunës së Prizrenit për vitin 2011, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës rreth miratimit të raportit të punës, të datës 15.2.2012, i prezantuar nga Komisioni për regjistrimin e inventarit dhe pajisjeve të tjera –pronë komunale në të gjitha objektet e Komunës së Prizrenit për vitin 2011, i formuar me aktvendim nr. 01/011-14114, datë 14.12.2011.

II. Bazuar në nenin IV të aktvendimit nr. 01/011-14114, datë 14.12.2011, anëtarët e komisionit si në vijim: 1. Naim Kukaj, kryetar, 2. Gëzim Gërgi, 3. Sefer Avduti, 4. Shpresa Osmanolli, 5. Haxhere Gavazaj, 6.Kujtim Gashi, 7. Merita Gorani, 8. Alban Hamzaj, 9. Merita Besimi, 10. Azem Bilibani, 11. Bashkim Lubovci dhe 12. Durak Thaçi, anëtar; do të kompensohen nga ana e KK-së në shumën prej 50 € për secilin anëtar. Puna e komisionit llogaritet si punë jashtë orarit të rregullt të punës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Drejtoria e Administratës, komisioni dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit.

Me këtë konkluzion të njoftohen Drejtoria e Administratës, komisioni, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-1595
Më 21.2.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 21.2.2012 me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Administratës –Zyra për Çështje Gjinore, të datës 14.2.2012, rreth lejimit të mjeteve financiare për organizimin dhe shënimin të Ditës Ndërkombëtare të Gruas - “8 Marsi”, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Administratës - Zyra për Çështje Gjinore, të datës 14.2.2012, rreth lejimit të mjeteve financiare për organizimin dhe shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas - “8 Marsi”, kështu që, për organizimin dhe kremtimin e kësaj feste tradicionale lejohet mbledhja e ofertave përkatëse.

Mjetet lejohen prej pozicionit të subvencioneve dhe mallrave e shërbimeve.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës - Zyra për Çështje Gjinore dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Administratës - Zyra për Çështje Gjinore, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/011-1783
Më 21.2.2012

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas propozimit të Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, për formimin e Komisionit për ndarjen e bursave për studentë dhe për fëmijë të dëshmorëve, të cilët janë në shkollat e mesme, kryetari i Komunës me 21 shkurt mori këtë

A K T V E N D I M

Për formimin, përbërjen, emërimin, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit për ndarjen e bursave për studentë, të cilët studiojnë në Universitetin publik, për vitin akademik 2011/2012

I. Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës, i datës 15.2.2012, rreth formimit të Komisionit për ndarjen e bursave për studentë, të cilët studiojnë në vitin akademik 2011/2012 dhe për fëmijë të dëshmorëve të cilët janë në shkollat e mesme.

II. Për anëtarë të këtij komisioni emërohen: 1. Nexhat Çoçaj, drejtor i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencës - kryetar, 2. Fahrije Bytyçi, drejtoreshë e Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe 3. Sencar Karamuqo, drejtor i Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë, anëtarë.

III. Detyrat e komisionit do të jenë: Të përgatisë konkursin për ndarjen e bursave për studentë dhe për fëmijë të dëshmorëve të shkollave të mesme, të përcaktojë kriteret e përfituesve të bursave, të shqyrtojë kërkesat dhe të bëjë përzgjedhjen e kandidatëve për bursë komunale.

IV. Komisioni nga pika II e këtij Aktvendimi, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, do t'i ushtrojë në pajtim me ligjin në fuqi.

Për zbatimin e këtij Aktvendimi, do të kujdesen: Drejtoria e Arsimit dhe e Shkencës dhe të emëruarit.

Me këtë Aktvendim, të njoftohen: Drejtoria e Arsimit dhe e Shkencës, të emëruarit dhe Arkivi.

Ky Aktvendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-1595
Më 21.2.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 21.2.2012 me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencë, të datës 15.2.2012, rreth lejimit të shpalljes së tenderit për rregullimin e fasadës termike në ShFMU “Mushnikova” në fshatin Mushnikovë, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencë, i datës 15.2.2012, rreth lejimit të rregullimit të fasadës termike në Shkollën Filllore të Mesme të Ultë “Mushnikova” në fshatin Mushnikovë, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-1595
Më 21.2.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 21.2.2012 me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencë, të datës 15.2.2012, rreth lejimit të shpalljes së tenderit për rregullimin e murit mbrojtës dhe rrethojës së ambientit në ShFMU “Lekë Dukagjini”, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencë, i datës 15.2.2012, rreth lejimit të rregullimit të murit mbrojtës dhe rrethojës së ambientit në Shkollën Filllore të Mesme të Ultë “Lekë Dukagjini” në Prizren, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-1595
Më 21.2.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 21.2.2012 me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencë, të datës 15.2.2012, rreth lejit të shpalljes së tenderit për rregullimin e kulmit të objektit të vjetër në ShFMU “Abdyl Frashëri”, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Arsimit dhe Shkencë, i datës 15.2.2012, rreth lejit të rregullimit të kulmit të objektit të vjetër në Shkollën Filllore të Mesme të Ultë “Abdyl Frashëri” në Prizren, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-1595
Më 21.2.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 21.23.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të datës 31.1.2012, rreth lejimit të organizimit dhe menaxhimit të festivalit të këngëve për fëmijë “Flutura-2012” dhe të festivalit të këngës së vjetër qytetare “Zambaku i Prizrenit-2012”, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Kulturës, të Rinisë dhe të Sportit, i datës 31.1.2012, rreth lejimit të organizimit dhe menaxhimit të edicionit të 11 të Festivalit të këngëve për fëmijë “Flutura-2012” (në kuadër të këtij festivali organizohet edhe Festivali për të rinj “Rock live-2012) dhe Edicionit të 24 të Festivalit të këngës së vjetër qytetare “Zambaku i Prizrenit-2012”, kështu që lejohet shpallja e konkurseve për organizimin dhe menaxhimin e këtyre festivaleve tradicionale.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-1595
Më 21.2.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 21.2.2012 me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Shëndetësisë, të datës 20.2.2012, rreth lejitimit të shpalljes së tenderit për sigurimin fizik të objektit të QKMF-së dhe të QMF-së në Lakuriq, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Drejtorisë së Shëndetësisë, i datës 20.2.2012, rreth lejitimit të sigurimit fizik të objektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe të Qendrës së Mjekësisë Familjare në Lakuriq, kështu që për këtë qëllim lejohet shpallja e tenderit përkatës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit.

Me këtë konkluzion të njoftohen Sektori i Prokurimit, Drejtoria e Shëndetësisë, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-1595
Më 21.2.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 21.2.2012 me drejtoritë komunale, shqyrtoi propozimin e Zyrës për Komunitete dhe Kthim, të datës 13.2.2012, për ndarjen e trojeve në pronësi të komunës për të riatdhesuarit, dhe mori këtë

K O N K L U Z I O N

U shqyrtua propozimi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, i datës 13.2.2012, për ndarjen e trojeve për të riatdhesuarit dhe atë në ngastrën kadastrorë nr. P-71813068-07326-2 në sipërfaqe prej 195 m² dhe në ngastrën kadastrorë nr. P-71813068-07326-1 në sipërfaqe prej 1273 m², në ZK Prizren në vendin e quajtur "Dardania-2", pronë e KK Prizren, me qëllim të ndërtimit të objekteve të banimit individual për vendosjen e të riatdhesuarve në Komunën e Prizrenit, të cilët do të sigurojnë donacione për ndërtimin e objekteve nga organizatat e ndryshme qeveritare dhe joqeveritare. Ky propozim i procedohet Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe vendimmarrje.

Obligohet Zyra për Komunitete dhe Kthim dhe Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor që, pas marrjes së këtij konkluzioni, të procedojë me lëndën në Komitetin për Politikë dhe Financa, Komisionin e Pronës dhe Kuvendin e Komunës.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Zyra për Komunitete dhe Kthim, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastrës.

Me këtë konkluzion të njoftohen Zyra për Komunitete dhe Kthim, Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Drejtoria e Gjeodezisë dhe Kadastrës, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja

REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Prizrenit
Kryetari i Komunës
Nr. 01/06-1595
Më 21.2.2012

Kryetari i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 21.2.2012 me drejtorinë komunale, shqyrtoi propozimin e Zyrës për Komunitete Lokale, të datës 14.2.2012, rreth lejitimit të udhëtimit zyrtar për në Mavrovë të Republikës së Maqedonisë dhe pagesës së mëditjeve për Orhan Lopar, nënkryetari i Komunës për komunitete dhe Islam Elshanin, punëtor i Shërbimit Civil të Komunës, dhe mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Miratohet propozimi i Zyrës për Komunitete Lokale, i datës 14.2.2012, për lejitimin e udhëtimit zyrtar dhe pagesën e mëditjeve për Orhan Lopar, nënkryetari i Komunës për komunitete dhe Islam Elshanin, punëtor i Shërbimit Civil të Komunës së Prizrenit, me qëllim të pjesëmarrjes në takimin vjetor të përfaqësuesve të Shoqërisë Civile të Komuniteteve Pakicë në Kosovë, që do të mbahet nga data 26 shkurt deri me 28 shkurt 2012 në Mavrovë të Republikës së Maqedonisë, kështu që për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar dhe pagesa e mëditjeve për të lartcekurit.

Për zbatimin e këtij konkluzioni do të kujdesen Zyra për Komunitete Lokale dhe Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit.

Me këtë konkluzion të njoftohen Zyra për Komunitete Lokale, Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe e Zhvillimit, të lartcekurit, si dhe Arkivi.

Ky konkluzion hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

Kryetari i Komunës
Prof. dr. Ramadan Muja